

Gjykata, në analizë të këtyre pretendimeve dhe prapësimeve të palëve, provave të paraqitura prej tyre, si dhe parashikimeve ligjore, çmon se kërkimet e paditësave janë të pabazuara. Ne vijim po parashtrijmë argumentet:

Së pari, pavaresisht-relatimit sipercituar, gjykata çmon të konkretizojë objektin e gjykimit, pasi kjo dikton dhe analizen dhe konkluzionet në vijim për secilet nga kërkimet objekt padie. Rezulton, jo vetëm nga të dhënat e kerkese padise në pjesën hyrëse të saj, por dhe shpjegimet në teresinë e saj, se paditësit kundërshtojnë aktet objekt gjykimi, duke pretenduar pavlefshmerinë e tyre absolute. Ky fakt u argumentua dhe në vendimin e ndërmjetem të Gjykatës për rrezimin e kerkese se paditësave për ndryshimin e objektit të padise, sipas të cilit ata kërkonin të ndyshonin objektin, duke i kundërshtuar këto akte si relativisht të pavlefshëm. Megjithatë, pavaresisht vendimmarrjes së ndërmjetme të gjykatës, serish paditësit, gjatë hetimit gjyqësor të çështjes dhe në konkluzionet përfundimtare në përfundim të hetimit gjyqësor, parashtruan dhe moren në analizë argumenta mbi pavlefshmerinë relative të këtyre akteve, duke i kërkuar në përfundim gjykatës që në mënyrë alternative, krahas konstatimit të pavlefshmerisë absolute të këtyre akteve, të vendosë dhe për shfuqizimin e tyre, si akte relativisht të pavlefshëm. Referuar parimit të njohur procedural, sipas të cilit gjykata shprehet për sa kërkohe dhe vetëm për sa kërkohe, në kushtet kur referuar dhe vendimmarrjes së ndërmjetme në lidhje me objektin padisë, për sa kohe që objekt gjykimi kemi vetëm pavlefshmerinë absolute të këtyre akteve, kjo gjykatë do të marrë në analizë vetëm këto pretendime. Për më tepër, kur kerkesa për ndryshimin e objektit të padise për kundërshtimin e këtyre akteve si relativisht të pavlefshëm u parashtrua në seancën gjyqësore të datës 16.06.2016, ndërkohe që aktet objekt gjykimi kanë dalë më datë 12.02.2016 dhe 03.03.2016. Pra, edhe sikur të ishin kushtet për të pranuar proceduralisht kerkesen për ndryshim të objektit të padise për kundërshtimin e këtyre akteve si relativisht të pavlefshëm, (pra sikur të mos ishte një kerkese që çonte në ndryshim të njëkohshëm të objektit dhe shkakut ligor, pra në kushtet e një padie të re) paditësit janë jashtë afatit ligjor për të ngritur një padi të tillë, pra kjo do të ishte një padi e parashtruar. Në këto kushte, Gjykata, në vijim, do të marrë në analizë vetëm argumentat në lidhje me pavlefshmerinë absolute të akteve objekt gjykimi dhe kërkimet e tjera objekt padie që janë rrjedhojë apo lidhen me të, sic dhe pretendohen nga paditësit në kerkese padi.

Së dyti, gjykata çmon të marrë në analizë legjitimitetin aktiv të paditësave për t'u drejtuar gjykatës për kundërshtimin e akteve objekt gjykimi. Sipas nenit 32 të K.Pr.Civile padia mund të ngrihet: a) për të kërkuar rivendosjen e një të drejte ose interesi të ligjshëm që është shkelur. Interesi i ligjshëm gjendet i pasqyruar dhe në dispozita të tjera procedurale që rregullojnë gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative nën 15 të ligjit nr. 49/2012 "Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative", të drejtën e ngritjes së padisë e ka: a) çdo subjekt, që pretendon se i është cenuar një e drejtë apo një interes i ligjshëm nga një veprim apo mosveprim i organit publik". Në kuptim të këtyre dispozitave procedurale civile, që të justifikohet ligjërisht kërkitimi për njohjen ose rivendosjen e një të drejte të shkelur ose të mohuar, kjo duhet të bëhet vetëm prej atij që i përket sipas ligjit e drejta e mohuar ose e shkelur prej një të treti (legjitimitet aktiv) dhe vetëm kundra atij që me veprën e tij, mohon ose shkel të drejtën e kërkuar (legjitimitet pasiv). Nga përmbajtja e këtyre dispozitave procedurale del se personi fizik apo juridik mund të hape një konflikt administrativ nëse plotësohen apo përmbushen dy kushte: Kushti i parë: akti administrativ duhet të jetë i paligjshëm. Kushti i dytë: paditësi të jetë cenuar në interesat e tij në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë. Legjitimiteti i palës në një proces gjyqësor nënkupton interesin legjitim dhe të vërtetë që duhet të ekzistojë ndërmjet palës dhe çështjes në shqyrtim. Interesi në gjykim është i lidhur me faktin se pa ndërhyrjen e gjykatës, pala do të pësonte një dëm. Interesi kërkohe të jetë konkret dhe jo i

supozuar që do të thotë se shkelja duhet të ketë ndodhur, dhe çështja të jetë gati për gjykim. Pra, interesi duhet të jetë aktual, cenimi i të drejtës duhet të ketë ndodhur palës në kohën që ngrihet padia, po kështu kërkohet që ky interes të vazhdojë të ekzistojë në kohën e gjyqimit. Në rastin konkret paditësit pretendojnë se Konventa e Aarhus-it u jep atyre të drejtë për t'iu drejtuar gjykatës për mbrojtjen e të drejtave, të pretenduara të cenuara, nga vendimmarrja e organeve publike objekt gjykimi. Kjo Konvente, e nënshkruar nga shteti Shqiptar dhe e ratifikuar me ligj, është pjese perberese e legjislacionit të brendshëm, qëndron në hierarkinë e burimeve të së drejtës më lart se legjislacioni i brendshëm, pra parimet e saj janë drejtpërdrejt të zbatueshme, nderkohe që ato janë bere pjese në parashikimet e legjislacionit të brendshëm si ligji nr. 10431, ligji nr. 107/2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit"; ligji nr. 10448, datë 14.7.2011 "Për lejet e mjedisit", ligji nr. 91/2013 "Për vlerësimin strategjik mjedisor" dhe ligji nr. 10440, datë 7.7.2011 "Për vlerësimin e ndikimit në mjedis" etj. Paditësit pretendojnë se bejne pjese ne bashkësinë e publikut, të ndikuar nga vendimmarrja e Bashkisë së Tiranës për kryerjen e punimeve të ndërtimit të parkut të lojërave brenda një zone me ndjeshmëri të lartë mjedisore dhe për me teper kur zona ku po ndërtohet parku i lojërave është shpallur zonë me rëndësi kombëtare nga vendimi i KKT nr. 4, dt.29.12.2014, sipas tyre legjitimitimi zgjerohet përtej qytetarëve të Tiranës, duke përfshirë të gjithë qytetarët e Republikës së Shqipërisë. Konventa e Aarhusit "Per te drejten e publikut per te pasur informacion, per te marre pjese ne vendimmarrje dhe per te ju drejtuar Gjykatës per ceshtjet e mjedisit", e nënshkruar nga shteti shqiptar me datë 25 Qershor 1998, ratifikuar nga Kuvendi i Shqipërisë me ligjin nr. 8672, datë 26.10.2000 "Per ratifikimin e Konventes se Aarhusit "Per te drejten e publikut per te pasur informacion, per te marre pjese ne vendimmarrje dhe per te ju drejtuar Gjykatës per ceshtjet e mjedisit" ne nenin 6 te saj "Pjesëmarrja e publikut në vendimet për veprimtari të veçanta" parashikon se : Çdo Palë do të zbatojë klauzolat e këtij neni, në lidhje me vendimet për lejlmin e veprimtarive të propozuara, sipas listës në Aneksin I. zbatojë klauzolat e këtij neni, në përputhje me ligjin e vet ndërkombëtar, edhe për vendimet mbi veprimtaritë e propozuara jo të listuara në Aneksin I, të cilat mund të kenë ndikim të rëndësishëm mbi mjedisin. Për këtë qëllim, Palët do të vendosin nëse një veprimtari e propozuar do t'u nënshirohet klauzolave të këtij neni. Referuar nenit 13 te Konventes Aneksit e saj jane pjese perberese e saj. Ne Aneksin I të Konventes janë percaktuar lista e aktiviteteve për të cilat pjesëmarrja publike është e domosdoshme, e konkretisht aktivitete të tilla si: sektori energjetik, i cili përbëhet nga: Rafineritë e naftës bruto dhe gazit natyror; Implantet e gazifikimit dhe likuidifikimit; Impiante për riprodhimin e lëndës djegëse rrezatuese bërthamore; etj, prodhimi dhe përpunimi i metaleve, industria minerale, industria kimike, menaxhimi i mbeturinave, implantet për trajtimin e ujërave të zeza, implantet e caktuara industrial, hekurudhat dhe aeroportet, rrugët ujore dhe portet, etj. Pra, janë pikerisht keto veprimtari (aktivitete) per te cilat Konventa iu njeht te drejten per qasje në informacione apo pjesëmarrje të publikut në procesin e vendimmarrjes. Po kështu, dhe legjislacioni i brendshëm ka percaktuar veprimtaritë dhe rastet e pergjegjesisë per demet qe i vijne mjedisit duke i percaktuar ato si veprimtari prodhuese prodhuese te rrezikshme, konkretisht ligji nr. 10431, datë 09.06.2011 "Për mbrojtjen e mjedisit", ligji nr. 10440, datë 07.07.2011, "Për vlerësimin e ndikimit në mjedis", i ndryshuar. Ne kete te fundit veprimtarite jane listuar ne shtojcat I dhe II te Ligjit dhe jane te njejta me veprimtarite e përcaktuara në Aneksin nr. I të Konventës së Aarhusit. Pra, rasti objekt gjykimi është një kënd lojrash për fëmijë, i cili nuk është listuar si veprimtari (aktivitet). Në kushtet kur Konventa e Aarhusit, por dhe legjislacioni i brendshëm u njeht subjekteve te drejten për t'iu drejtuar Gjykatës, për çështjet që kanë të bëjnë me veprimtari të caktuara në menyre te shprehur dhe në kushtet kur veprimtaria e zhvilluar me aktet objekt gjykimi nuk ben pjese ne asnje asnjë nga veprimtaritë e listuara ne aneksin e Konventes dhe

ato te legjislacionit te brendshem, atëherë paditësit nuk mund të kenë akses në vendimmarrje dhe akses per kundërshtimin e kësaj vendimmarrje në gjykatë.

Po kështu, Konventa Aarhus-it, si nje instrumnet juridik nderkombetar, përfaqëson një tërësi të drejtash, detyrimesh, rregullash e procedurash të detyrueshme për zbatim për shtetet që e nënshkruajnë dhe e ratifikojnë. Kërkesat e Konventës, të drejtat dhe detyrimet që ajo përmban, janë orientuar në momente kyç të marrëdhënieve mjedisore dhe grupohen në tri drejtime themelore të tyre që jo pa qëllim janë quajtur edhe tri shtyllat e Konventës:

1. E drejta e publikut për të patur e për të kërkuar informacion mjedisor;
2. E drejta e publikut për të marrë pjesë në vendimmarrjet publike për çështje të mjedisit;
3. E drejta e publikut për t'u ankuar në gjykatë për çështje të mjedisit.

Sic me siper u citua, duke qenë pjesë e kësaj Konvente, Shqipëria ka miratuar ligje të cilat synojnë zbatimin e tre shtyllave kryesore të Konventës së Aarhus-it dhe përkatësisht: (i) aksesin në informacionin mjedisor; (ii) akses në vendim-marrjen mjedisore; (iii) akses në drejtësi për çështjet mjedisore.

Akcesi në informacionin mjedisor rregullohet në Shqipëri në mënyrë të dyfishtë: nga ligji i posaçëm për mjedisin, përkatësisht ligji nr. 10431, datë 9.6.2011 "Për mbrojtjen e mjedisit" si dhe nga ligji i përgjithshëm për të drejtën e informimit në të gjitha fushat, përfshirë edhe mjedisin, përkatësisht Ligji nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit".

Në mënyrë të ngjashme aksesin në vendimmarrjen mjedisore rregullohet nga ligje të posaçme për mbrojtjen e mjedisit siç janë Ligji nr. 10431, datë 9.6.2011 "Për mbrojtjen e mjedisit" dhe Ligji nr. 10440/2011 "Për vlerësimin e ndikimit në mjedis" dhe aktet përkatëse nënligjore, si dhe nga ligji i përgjithshëm mbi konsultimin publik në çështjet me interes publik ku domosdoshmërisht përfshihen çështjet me impakt mjedisor, përkatësisht Ligji nr. 146/2014 "Për njoftimin dhe konsultimin publik".

Akcesi në drejtësi për çështjet mjedisore, i konsideruar si shtylla thelbësore e Konventës së Aarhus-it pa ekzistencën e së cilës të drejtat e parashikuara nga dy shtyllat e tjera janë të pazbatueshme, rregullohet gjithashtu nga legjislacioni shqiptar me anë të legjislacionit të posaçëm për mbrojtjen e mjedisit dhe së fundmi me anë të Ligjit Nr. 49/2012 "Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative".

Po kështu, Konventa e Aarhusit "Per te drejten e publikut per te pasur informacion, per te marre pjese ne vendimmarrje dhe per te ju drejtuar Gjykatës per ceshtjet e mjedisit", e nënshkruar nga shteti shqiptar me datë 25 Qershor 1998, ratifikuar nga Kuvendi i Shqiperise me ligjin nr. 8672, datë 26.10.2000 "Per ratifikimin e Konventes se Aarhusit "Per te drejten e publikut per te pasur informacion, per te marre pjese ne vendimmarrje dhe per te ju drejtuar Gjykatës per ceshtjet e mjedisit" u njuh paditesave te drejten per t'iu drejtuar Gjykatës, për çështjet që kanë të bëjnë me qasjen në informacione apo pjesëmarrje të publikut në procesin e vendimmarrjes, nderkohe që nga pikepamja procedurale padia objekt gjykimi është një padi me natyre kundërshtuese pasi kerkohet konstatimi i pavlefshmerise absolute te akteve.

Ligji nr. 49/2012 "Per organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative", padine kundërshtuese e ka percaktuar ne pikat a,b,c te nenit 17, ndersa padine detyruese ne piken "ç" te ketij neni. Padia detyruese e percaktuar ne

piken "ç" te nenit 17 te ligjit nr. 49/2012, "Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative", i ndryshuar, ngrihet për të detyruar organin publik të kryejë një veprim administrativ, që është refuzuar, apo për të cilin organi publik ka heshtur, ndonëse ka pasur kërkesë. Ky është një argument me shume per te vleresuar Gjykata se paditesit në këtë gjykim, nuk kane legjitimim aktiv per te kërkuar nepermjet nje padie kundërshtuese konstatimin e pavlefshmërisë absolute te akteve objekt gjykimi.

Paditesit pretenduan se jane dhe pjese e aktiviteteve "Nisma për qytetaret", organizim i krijuar për mbrojtjen e Parkut te Liqenit nga ndërhyrjet e paligjshëm te subjekteve private dhe publike, perfshi dhe mbrojtjen e mjedisit nga veprimet e paligjshme te kryera nga Bashkia Tirane ne ndertimin e parkut te lojrave ne Kuroren e Gjelber te Qytetit te Tiranës. Gjykata çmon se edhe ne rast se paditesat jane te organizuar si nje grupim interesi (fakti te cillin nuk e provuan përpara gjykates, por padine e paraqiten ne menyre individuale dhe jo si nje grupim interesi i organizuar ne baze te ligjeve ne fuqi), ata nuk legjitimohen ne ngritjen e kësaj padie, pasi neni 15 /d i ligjit nr 49/2012 "Per organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative", ka parashikuar kushte te veçanta , kushte te cilat paditesit nuk i plotesojne.Me konkretisht neni 15/d i ligjit nr 49/2012 "Per organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative" parashikon: "Te drejten e ngritjes se padise e ka ..." d) çdo shoqatë apo grup interesi që pretendon se është cenuar një interes i ligjshëm publik:

i) nga një akt normativ;

ii) nga një akt administrativ, në rast se një e drejtë e tillë u njihet me ligj;

dh) çdo subjekt tjetër, të cilit kjo e drejtë i njihet shprehimisht me ligj".

Në rastet e shoqatave apo te grupit te interesit legjitimimi lidhet me rastet kur pretendojnë se është cenuar një interes i ligjshëm publik: (i) nga një akt normativ; (ii) nga një akt administrativ, në rast se një e drejtë e tillë u njihet me ligj". Pra, Gjykata çmon se legjitimimi i shoqatave dhe grupeve të interesit është i kufizuar nga legjislacioni shqiptar, pasi një shoqatë apo grupim interesi mund të ankohet në gjykatë vetëm për të shfuqizuar një ligj apo akt që cënon interesin publik, por nuk mund të kërkojë shfuqizimin e nje akti administrative individual, ne rastin kur interesi i ligjshëm publik cënohet nga një veprim apo mosveprim i administratës publike, siç është pretendimi i paditesave ne rastin objekt gjykimi.

Se trett, neni 116 i K.Pr.Administrative parashikon: " Aktet administrative do të quhen absolutisht të pavlefshme, në kuptimin e këtij Kodi, në rastet e mëposhtme:

a) kur akti është nxjerrë nga një organ administrativ i paidentifikuar;

b) kur akti është nxjerrë nga një organ administrativ në kapërcim të kompetencave të tij ligjore;

c) kur akti është nxjerrë në kundërshtim me formën dhe procedurën e kërkuar nga ligji".

Ne rastin konkret Gjykata çmon se nuk jemi perpara asnje prej ketyre rasteve, pasi:

A) Aktet jane nxjerre nga organe te identifikuar. Me konkretisht vendimi nr.1, datë

12.02.2016, "Per miratimin e lejes së ndërtimit për objektin "Këndi i Lojrave për Fëmijë, Projekti Pilot 4, në kuadër të rehabilitimit të Liqenit, Bashkia Tiranë " është nxjerre nga Këshilli Kombëtar i Territorit, po kështu dhe leja e ndërtimit datë 03.03.2016 për objektin "Këndi i Lojrave për Fëmijë, Projekti Pilot 4, në kuadër të rehabilitimit të Liqenit, Bashkia Tiranë", në favor të zhvilluesit Bashkia Tiranë" është nxjerre nga pala e paditur KRRT, konkretisht, në referim të përashikimeve të VKM nr. 725, datë 02.09.2015 "Per miratimin e organizimit dhe funksionimit të Agjensisë së Zhvillimit të Territorit" nga Agjensia e Zhvillimit të Territorit, e cila vepron si Sekretariat Teknik i Këshillit të Rregullimit të Territorit.

B) Aktet janë nxjerre brenda kufijve të kompetencave që ju njeh kuadri ligjor dhe nenligjor në fuqi organeve që i kanë nxjerre ato. Kështu, referuar nenit 27 të ligjit nr.107, datë 31.07.2014 "Për Planifikimin dhe zhvillimin e territorit" "Autoritetet përgjegjëse" i cili parashikon: " Autoritetet përgjegjëse për zhvillimin e territorit janë: 1. Këshilli Kombëtar i Territorit. 2. Kryetari i Bashkisë", nenit 28 të po këtij Ligji "Përgjegjësitë e KKT-së" i cili parashikon: "1. KKT-ja është autoriteti përgjegjës për vendimmarrjen për leje zhvillimi dhe leje ndërtimi për llojet e zhvillimit komplekse, të përcaktuara në rregulloren e zhvillimit, dhe ato që lidhen me çështje, zona, objekte të rëndësishme kombëtare apo me investime strategjike për interesat e vendit, mbi propozimin e ministrisë që mbulon sektorin apo zhvillimin përkatës. 2. Lëshimi i certifikatës së përdorimit për lejet e ndërtimit, të miratuara sipas pikës 1, të këtij neni, kryhet në përfundim të një procesi të bashkërenduar të kontrollit të përputhshmërisë së ndërtimit mes autoriteteve qendrore të përfshira, sipas fushës së kompetencës, dhe autoritetit vendor përgjegjës për kontrollin e punimeve të ndërtimit në territorin administrativ ku kryhet zhvillimi. 3. Procedurat e detajuara për shqyrtimin dhe miratimin e kërkesave për leje zhvillimi dhe/ose ndërtimi, sipas pikës 1, të këtij neni, dhe lëshimin e certifikatës së përdorimit përkatëse përcaktohen në rregulloren e zhvillimit", si dhe nenit 19/3 të VKM Nr. 408, datë 13.5.2015 "Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit", dale në bazë dhe për zbatim të ligjit nr.107, datë 31.07.2014 "Për Planifikimin dhe zhvillimin e territorit", "Lejet e ndërtimit për të cilat është përgjegjëse KKT-ja" i cili parashikon: " 3. Këshilli Kombëtar i Territorit është autoriteti përgjegjës për miratimin e lejeve të ndërtimit për çështje, zona apo objekte të përcaktuara si të rëndësishme kombëtare, përfshirë edhe ato që ngrihen në pronat shtetërore të patransferuara të njësitë e qeverisjes vendore".

C) Aktet janë nxjerre në përputhje me formën dhe procedurën e përcaktuar nga ligji. Respektimi i formës dhe i procedurës për nxjerrjen e aktit administrativ përbën një tjetër element të rëndësishëm që përcakton vlefshmërinë e tij. Shkelja e formës dhe e procedurës mund të paraqitet në mënyra të ndryshme, por jo të gjitha shkeljet që lidhen me formën dhe procedurën cojnë detyrimisht në pavlefshmërinë e aktit. Mosrespektimi i këtyre elementëve duhet të jetë i atij karakteri dhe asaj rëndësie që të ketë ndikuar drejtpërdrejt në nxjerrjen e aktit administrativ. Një shkelje e parëndësishme e procedurës apo formës së aktit nuk mund të shkaktojë pavlefshmëri absolute të aktit. Neni 107 i K.Pr. Administrative parashikon: "Qëllimi i aktit" parashikon: 1. Aktet administrative, në çdo rast, tregojnë qëllimin e tyre.

2. Pavarësisht nga çdo informacion tjetër që mund të jepet nga organi administrativ rast pas rasti, secili akt administrativ duhet patjetër të përmbajë sa më poshtë:

a) Autoritetin që e nxjerr aktin, si dhe çdo delegim të pushteteve që lidhet me nxjerrjen e aktit;

b) identifikimin e palëve, të cilave iu drejtohet akti;

c) shpjegimin e fakteve, që janë bërë shkas për nxjerrjen e aktit, kur këto janë të

rëndësishme:

c) bazën ligjore të aktit kur kërkohet nga ligji:

d) shpëligimin e kuptimit të aktit:

dh) datën e hyrjes në fuqi të aktit:

e) nënshkrimin e punonjësit të organit që nxjerr aktin ose të drejtuesit të organit

kolegjal". Po kështu, referuar parashikimeve të nenit 108 të K.Pr. Administrative aktet objekt gjykimi janë të arsyeuara. Per sa i perket procedures, Gjykata gjithashtu çmon se aktef objekt gjykimi kane dale ne perputhje me rregullat proceduriale te percaktuara ne ligjet dhe aktet neligjore ne fuqi dhe që rregullojne kete marredhenie. Pretendimi i paditësave se, ndryshe nga sa parashikohet ne menyre të shprehur ne piken 3 te vendimit nr.1, datë 12.02.2016, "Per miratimin e lejes së ndërtimit për objektin "Këndi i Lojrave për Fëmijë, Projekti Pilot 4, në kuadër të rehabilitimit të Liqenit, Bashkia Tiranë ", sipas te cilit dokumenti i lejes se se ndertimit i jepet subjektit vetem pas marrjes, nder te tjera, dhe te konformitetit nga Ministria e Mjedisit dhe dhe Agjensia Kombetare e Planifikimit te Territorit, pala e paditur ka nxjerre lejen pa u marre konformiteti. Ne gjykim u provua që Agjensia e Zhvillimit te Territorit, e cila siç me siper u cituara, referuar parshikimeve te VKM nr. 725, datë 02.09.2015 "Per miratimin e organizimit dhe finksionimit te Agjensise se Zhvillimit te Territorit" vepron si Sekretariat Teknik i Këshillit të Rregullimit te Territorit iu është drejtuar Ministrisë së Mjedisit dhe Agjensise Kombetare te Planifikimit te Territorit per te marre konformitetin. Me shkresen nr. 390/01, datë 02.03.2016 Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit shprehet se konformiteti i projektit është dhene perpara se ai te hynte ne procedurat e aplikimit per leje ndertimi dhe rrjedhimisht nuk ka qënë e nevojshme që te perfshihej si kusht per dhenien e lejes se ndertimit te objektit. Me konkretisht ne kete shkrese thuhet ne menyre te shprehur se: "Projekti për Parkun e Lodrave brenda Parkut të Liqenit është pjesë e Masterplanit të hartuar për parkun, nëpërmjet një procesi "shërbim konsulentë", realizuar nga Fondi Shqiptar i Zhvillimit. Projekti është hartuar nga një studio projektimi e specializuar, ndërkohë që procesi është ndjekur dhe nga Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit që prej hartimit të Termave të Referencës dhe deri në dorëzimin e projekteve teknike për secilin prej projekteve pilot, pjesë e Masterplanit.

Ndër të tjera AKPT-ja informon se, Parku i Liqenit është pjesë e Kurorës së Gjelbër të Tiranës dhe Zonë e Rëndësishme Kombëtare. Për këtë arsye është parë e nevojshme nga dy Institucionet –Fondi Shqiptari Zhvillimit dhe Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit që ta ndjekin procesin së bashku dhe mbi bazën e një akt-marrëveshje lidhur në datë 23.01.2015, ku FSHZH është palë në cilësinë e autoritetit kontraktor dhe AKPT-ja luan rol në asistencë teknike në projektim. Ndërkohë që vetë Shërbimi i Konsulencës është kërkuar nga FSHZH për "Përgatitjen e Masterplanit të Parkut të Liqenit dhe 5 projekte pilot". Në fund, AKPT-ja sqaron se konformitetit i këtij projekti është dhënë përpara se projekti të hynte në procedurat e aplikimit për leje ndërtimi. Për këtë arsye, gjykoj se nuk ka qënë aspak e nevojshme që të shprehej ne vendimin e KKT-së kushti për marrjen e konfirmimit nga AKPT".

Po kështu, konform parashikimit ne vendimin objekt gjykimi, Agjensia e Zhvillimit te Territorit i është drejtuar me shkrese dhe Ministrise se Mjedisit per marrjen e konformitetit dhe, kjo e fundit, me shkresen nr. 1291, datë 01.03.2016 i ka kthyer pergjigje ne menyre te shprehur se: "Projekti "Kend lojrash per femije" nuk është listuar ne shtojcat I dhe II te ligjit nr. 10 440, datë 07.07.2011 "Per vleresimin e ndikimit ne mjedis' te ndyshuar". Referuar te dhenave te ketyre provave Gjykata çmon se ne rastin konkret nga pala e paditur jane permbushur plotesisht detyrimef që kushtezojne nga pikepamja proceduriale nxjerrjen e aktit objekt gjykimi leje ndertimi per objektin "Kend lojrash per femije" dhe që lidhet me kryerjen e te gjitha veprimeve per marrjen e konformitetit per objektin. Nderkohe diskutimi nese ky konformitet duhej dhene apo jo nga struktura perkatese me shume se sa me

proceduren e nxjerrjes se aktit ndikon ne bazueshmerine e aktit nga pikepamja e ligjit material, pra me pavlefshmerine relative te ketij akti, e cila sic me siper u citua, nuk është objektit i ketij shqyrtimi gjyqësor. Ne keto kushte gjykata çmon se aktet objekt nuk jane absolutisht te pavlefshem per asnje nga rastet e parashikuara ne menyre te shprehur nga ligji, rrjedhimisht nuk mund te koptatohen si te tille nga gjykata. Kerkimet objekt padie per kete pjese jane te pabazuar e si te tille duhen rrezuar.

Së katërti, te pabazuar e gjen gjykata pretendimin e paditësave ne lidhje me paligjshmerinë e procedurës së prokurimit të punimeve të ndërtimit të parkut të lojërave, me argumentin se kjo procedure ka nisur që në datën 14 Dhjetor 2015, pra afërsisht 2 (dy) muaj përpara miratimit të lejes së ndërtimit me kusht me anë të vendimit nr. 1, datë 12.02.2016 te KRRT-së, dhe se sipas te dhenave te tabelës së punimeve, punimet kanë nisur më datë 10 Shkurt 2016, pra 2 (dy) ditë përpara. Pala paditëse nuk e bazoi kete pretendim ne ndonje reference ligjore dhe prove konkrete. Per me teper natyra e ketij kerkimi ishte e pergjithshme, pra paditësit nuk percaktuan në asnje moment aktin apo veprimin administrativ konkret qe kundërshtonin, detyrim ky që binte mbi ta referuar nenit 21 te ligjit 49/2012 "Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative", ne nje kohe kur kjo procedure perfshin një teresi aktesh dhe veprimesh administrative të Autoritetit Kontraktor Bashkia Tirane dhe që janë finalizuar me lidhjen e kontrates se prokurimit, e cila gjithashtu nuk u identifikua dhe kundërshtua ne menyre te shprehur prej tyre. Nderkohe rastet e pavlefshmerise absolute te kësaj te fundit jane percaktuar ne menyre te shprehur ne legjislacionin e posaçem per prokurimin publik. Per me teper, vlen te theksohet se legjislacioni per prokurimin publik ka percaktuar dhe struktura administrative dhe afteve brenda te cilave keto akte te procedures se prokurimit mund te goditen, duke kushtezuar aksesin ne gjykate, me ezuarimin paraprakisht te rekursit administrativ. Po kështu, të pabazuar e gjen gjykata pretendimin e paditësave se keto procedura jane te pavlefshme ne kushtet kur aktet per miratimin e lejes se ndertimit te parkut te lojrave jane te tilla. Kjo pasi, siç me siper u citua, gjykata çmoi se aktet objekt gjykimi per miratimin e lejes nuk jane akte absolutisht te vlefshme, rrjedhimisht nuk mund te behet fjale per pavlefshmeri te akteve dhe veprimeve juridike ne kuader te procedures se prokurimit publik te zhvilluar nga pala e paditur Bashkia Tiranë per percaktimin e operatoreve ekonomike per realizimin e objektit.

Së pesti dhe ne vijim te arsyetimit te sipercituar dhe kerkimi objekt padie per konstatimin e paligjshmerisë se punimeve te ndërtimit te zhvilluesit Bashkia e Tiranës është i pabazuar e si i tille duhet rrezuar. Po kështu, ne kushtet kur aktet per miratimin e lejes së ndertimit dhe leja e ndertimit jane akte te vlefshme dhe procedura e ndjekur e prokurimit është e tille, rrjedhimisht nuk mund te detyrohen palet e paditura te nderpresin punimet apo te rikthejnë zonen ne gjendjen e meparshme. Per me teper kerkimi i paditësave per ndalimin e punimeve ka humbur aktualitetin, ne kushtet kur objekti ka perfunduar. Kerkese padia dhe per kete pjese është e pabazuar e si e tille duhet rrezuar.

Së gjashti, për sa u përket shpenzimeve gjyqësore, gjykata çmon se, përderisa kërkese padia rezultoi e pabazuar, bazuar në nenin 106 te K.Pr.Civile ato duhet t'i ngarkohen paditësave. Këto shpenzime përbëhen nga shpenzimet e verifikuara, te renditura në fund te ketij vendimi.

Në përfundim, duke pasur parasysh gjithë sa më sipër u citua, gjykata çmon se kërkese padia e paditësve Anxhela Hoxha, Artan Manushaqe, Andi Tepelena, Brizida

Gjikondi, Ervin Goci, Eljan Tanini dhe Rezarta Çaushaj është e pabazuar në ligj dhe në prova, e si e tillë duhet rrezuar.

PER KETO ARSYE:

Gjykata, bazuar në nenet 40, 41 të ligjit nr. 49/ 2012 "Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative",

VENDOSI:

- Rrëzimin kërkesë padisë së paditësave Anxhela Hoxha, Artan Manushaqe, Andi Tepelena, Brizida Gjirikondi, Ervin Goci, Eljan Tanini dhe Rezarta Çaushaj, të paditura Bashkia e Tiranës, Këshilli Kombëtar i Territorit, shoqëria "Star Tek" sh.p.k, dhe shoqëria "Riviera" sh.p.k, me objekt: "Sigurimin e padisë duke vendosur pezullimin e lejes së ndërtimit dt.03.03.2016, për objektin "Këndi i lojërave për fëmijë, projekti pilot 4, në kuadër të rehabilitimit të parkut të liqenit", dhe zhvilluesit Bashkia Tirane. Marrjen e masave shtese të sigurimit të padisë, duke vendosur pezullimin e menjëhershëm të punimeve dhe veprimeve të Bashkise Tirane dhe nenkontraktoreve të saj brenda zonës së rendesise Kombëtare, Kurora e Gjelbër e Tiranës dhe përkatësisht, Zonën Kadastrale nr.8280 me Nr.Pasurie 2/280, Nr.pasurie 2/283 (zona e ndërtimit), për Projektin "Këndi i Lojërave për fëmijë" të prokuruar nga Bashkia Tirane. Konstatimin e pavlefshmërisë absolute të vendimit nr.1, datë 12.02.2016 të Këshillit Kombëtar të Territorit për miratimin e lejes së ndërtimit për objektin "Këndi i Lojërave për fëmijë, projekti pilot 4", në kuadër të rehabilitimit të parkut të liqenit, Bashkia Tirane. Konstatimin e pavlefshmërisë së lejes së ndërtimit, datë 03.03.2016, të KKT-se të lëshuar për zhvilluesin Bashkia Tirane. Konstatimin e pavlefshmërisë së lejes së ndërtimit, datë 03.03.2016, të KKT-se, të lëshuar për zhvilluesin Bashkia Tirane, për objektin "Këndi i lojërave për fëmijë, projekti pilot 4, në kuadër të rehabilitimit të parkut të liqenit, Bashkia Tirane", bazuar në VKT nr.1, për zhvillimin e pronave të ndodhura në zonën Kadastrale nr.8280 me nr.pasurie 2/280, Nr.pasurie 2/281 dhe Nr.pasurie 2/283; Shpalljen e pavlefshmërisë së procedurës së prokurimit me objekt kryerjen e punimeve për "Këndin e Lojërave për fëmijë", për fondin limit prej 67 983 445 leke pa TVSH (.Buletini nr.49/2015). Konstatimin e paligjshmërisë së punimeve të ndërtimit të zhvilluesit Bashkia e Tiranës, të kryera në pasurie të ndodhura brenda zonës së rendesise Kombëtare, Kurora e Gjelbër të Tiranës dhe përkatësisht, Zonën Kadastrale nr.8280 me nr.pasurie 2/280, nr.pasurie 2/281 dhe nr.pasurie 2/283 (zona e ndërtimit), për projektin "Këndi i Lojërave për fëmijë" të prokuruar nga Bashkia e Tiranës. Detyrimin e Bashkise së Tiranës për të ndaluar punimet e ndërtimit dhe për rikthimin e zonës në gjendjen e mëparshme", si e pabazuar në ligj dhe prova.
- Shpenzimet gjyqësore në ngarkim të paditësave.
- Kundër këtij vendimi lejohet ankimi në Gjykatën Administrative të Apelit Tiranë, brenda 15 ditëve, duke filluar ky afat nga e nesërmbja e shpalljes. Për palët dhe avokaturën e shtetit në mungesë, ky afat fillon nga e nesërmbja e njoftimit të vendimit.

- Vendimi t'u komunikohet paleve dhe avokatures se shtetit në mungese.
- U shpall sot, në Tiranë, më 11.07.2016

SEKRETARE
QEREME BODURI

GJYQTARE
SELVIE GJOÇAJ

Shpenzime gjyqësore

Takse gjyqësore **3000 lekë**

Gjithësej **3000 lekë**